



[shqiptaria.com]

2. Në orën 23:25 deri ne 01:25, është realizuar kontroll nga Policia e Burgjeve për kontrollin e të burgosurve, si dhe të ambienteve të qelive apo ambienteve të përbashkëta, për konstatimin dhe evidentimin e sendeve të ndaluara në regjimin e brendshëm. Forcat e Policisë ushtruan kontroll edhe në Sektorin Nr.5, Kati 2-të, Dhoma 4, ku ishin të akomoduar të paraburgosurit:
- Hajri Myrteza Seferi¹,
 - Astrit Zeqo Avdyli alias Avdyli Sulejmani²
 - Altin Zeqo Avdyli³,
 - Saimir Abdyl Gjepali⁴
 - Giovanni Giuseppe Di Cosimo alias Giovanni Petrone⁵,

Për 4 të parët (Hajri Seferi, Astrit dhe Altin Avdyli dhe Saimir Gjepali - Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë⁶ ka caktuar masën e sigurimit "arrest në burg"

- për kryerjen e veprës penale "*Prodhimi dhe shitja e narkotikeve*", "*Trafikimi i narkotikeve*" e kryer në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar Kriminal", "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*" dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale*", të parashikuar nga nenet 283,283/a,287, 333/a, 334 të Kodit Penal.

ndërsa për Giovanni Giussepë - Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda⁷ ka caktuar masën e sigurimit "arrest në burg",

- për kryerjen e veprës penale të "*Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve*", "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" dhe "*Grup i strukturuar kriminal*", parashikuar nga nenet 283/1, 287 dhe 333/a i Kodit Penal.

3. Sapo Forcat e Policisë hapën derën e dhomës Nr. 4, të paraburgosurve ju komunikua "policia për kontroll" u konstatua se në kundërshtim me rregulloren e burgut në dhomë nuk kishte ndriçim (*ishte fikur drita*). Pas njoftimit/thirrjes së policisë për kontroll të gjithë të paraburgosurit e kësaj dhome u ngritën në këmbë dhe kundërshtuan kontrollin në mënyrë demonstrative, duke kundërshtuar forcërisht, dhe duke shtyrë punonjësit e policisë më forcë
4. Në parvazin e dritares së dhomës u konstatua prania e një telefoni celular, i tipit Samsung, ngjyrë e kaltër (send i ndaluar që përbën vepër penale të parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal). Me hyrjen në dhomë forcat e policisë bllokuan derën e tualetit për të mos patur mundësinë që të paraburgosurit të hidhnin sendet e ndaluara⁸.
5. Më pas në prezencë të paraburgosurit Saimir Gjipali filloi kontrolli i dhomës, ku u konstatua;
- një karikues aparati celular Samsung me fish të bardhë.
 - një fish karikimi për markën "Apple".

¹ I datëlindjes 22.07.1977, lindur dhe banues në Shijak, Durrës.

² i datëlindjes 06.09.1974, lindur dhe banues në Shijak, Durrës.

³ I datëlindjes 27.02.1977, lindur dhe banues në Shijak, Durrës.

⁴ I datëlindjes 02.04.1974, lindur dhe banues në Shijak, Durrës.

⁵ I datëlindjes 11.03.1978, lindur në Bari Itali dhe banues në Durrës.

⁶ Me vendimin nr. 157 dhe 158, datë 21.10.2018.

⁷ Me vendimin Nr. 186, datë 08.12.2018.

⁸ Pasi ka patur shumë raste që të burgosur të ndryshëm përdorin tualetin për të hedhur sende të ndaluara që përbëjnë vepër penale, me qëllim që mos ju kapet.




Foto të aparatit celular të gjetur në dhomën e të burgosurve të sipërpërmendur (fotografimi i aparatit është kryer më pas natyrisht). Foto tjetër është momenti kur punonjësi i policisë nxjerr jashtë dhomës celularin e gjetur

6. Për dokumentimin e ngjarjes së mësipërme u hartua dokumentacioni përkatës, raporti i shërbimit, akt-konstatimi të sendit të ndaluar, proces-verbal bllokimi dhe proves-verbal dorëzimi, ndërsa më pas secili punonjës pjesëmarrës në këtë operacion kanë dhënë deklarime individuale.
- Në lidhje me sendet e gjetura, asnjë i burgosurit nuk pranoi autorësinë (celular, karikues, fishë karikimi apple), e nuk bëhet fjalë për të dhënë shpjegime të hollësishme, e bashkëpunuar me kontrollin për hapjen e marrjen e informacionit nga aparati celular
 - madje madje të paraburgosurit pretendonin se celularin mund ta ketë kaluar pastruesi⁹.
 - Ndërsa i paraburgosuri Saimir Gjipali i cili ishte prezent gjatë gjithë kohës së kontrollit insistoi të merrte kontakt me pastruesin me qëllim që sendin ta merrte përsipër pastruesi, por që nuk u lejua nga forcat e policisë. *Kjo sjellje e tyre është tregues i qartë i sigurisë së tyre që i burgosuri tjetër do pranojë (ndonëse do ishte fakt absurd)pronësinë e sendit të ndaluar, pra është tregues i qartë që kanë aftësi dhe nënshtruar të burgosurin në fjalë e që mund të përfitojnë prej tij.*
 - *Raste të njohura edhe më parë ne sistem¹⁰.*
 - Në përfundim të kontrollit të gjithë të paraburgosurit e dhomës Nr. 4 u shoqëruan në dhomat e veçimit.

⁹ Një i burgosur tjetër që kryen pastrimin e ambienteve të përbashkëta por që nuk është në dhomën ku u gjet celulari.

¹⁰ Evidentojmë një rast krejt analog: me datë 20.5.2019 nga kontrolli i forcave të sigurisë në dhomën e anëtarëve të një tjetër grupi të strukturuar kriminal (Astmer Bilali, Sadetin Erkoçeviq, Behar Brajoviq dhe Samet Halluni) u gjetën dy aparate celular – lidhur me të cilët të burgosurit dhanë 'shpjegime' se celularët janë të një të burgosuri të një dhome tjetër (astrit Voça) – fakt për të cilin kemi dëgjimi se tashmë janë në procedim penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 324/a dhe 300 të K. Penal

- Sendet e gjetura u dorëzuan me proces-verbal dhe u njoftua Specialisti i SHKBB-së për veprime të mëtejshme.
- II. Nga shqyrtimi i materialeve lidhur me rastin, rezulton se këta të paraburgosur kanë kryer shkelje shumë të rënda
- Rrezikojnë sigurinë dhe prishin rregullin në institucion
 - Përpiqen të detyrojnë të paraburgosurit e tjerë që t'ju nënshtrohen e përfitojnë prej tyre
 - Nxisin të tjerët të shkelin rregullat
 - Mosbindje ndaj autoritetit të punonjësit të policisë
 - Kërcënime e kanosje serioze për jetën ndaj punonjësve të policisë dhe familjarëve të tyre
 - Moskallëzim krimi
- I. Futja, mbajtja dhe përdorimi i sendeve të ndaluara në burg është veprim haptazi në kundërshtim me rregulloren e burgut e madje është vepër penale¹¹
- Problematika tejet e rëndë e futjes së sendeve të ndaluara në ambientet e regjimit të brendshëm, nuk konsiston dhe përkthehet mirëfilli, vetëm në një element të rrezikshëm që lidhet thjesht me cenimin apo dhe shkeljen e elementëve të skemës së sigurisë¹² që duhet të ekzistojë në burgje, por në vetvete përbën një akses të rrezikshëm mbi qëllimin e përdorimit të tyre nga të burgosurit, ku jo në pak raste kanë shërbyer edhe për ardhjen e pasojave kriminale shumë të rrezikshme si brenda apo dhe jashtë burgjeve¹³.
 - Fenomeni i paligjshmërisë së futjes së sendeve të ndaluara në mjediset e IEVP-ve, në ditët e sotme përbën një sfidë tejet shqetësuese dhe tepër aktuale në sistemin penitenciar.
 - Evidentojmë se ka shumë interes që në kuadër të procedimit penal ndaj tyre për veprën penale të parashikuar nga ky nen (324/a – futja e mbajtja e sendeve të ndaluara në burg) të mund të identifikohen personat me të cilët kanë koordinuar e komunikuar jashtë burgut dhe qëllimin e tyre, apo dhe personat brenda burgut të cilët i kanë ndihmuar për të futur këtë send të ndaluar apo që me mos-veprimet e tyre kanë facilituar përdorimin e tyre pa u shqetësuar nga të paraburgosurit (pra nuk ja u kanë kapur celularin).
 - Këta të paraburgosur kanë konsumuar edhe një shkelje tepër të rëndë të parashikuar në gjurmën 'c' dhe 'f' të nenit 24 të VKM Nr. 437 datë 20.05.2015 "Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve"¹⁴ dhe natyrshëm që këta të burgosur e kanë përdorur këtë send të ndaluar që kanë patur në dhomë.

¹¹ Në vitin 2015 parandalimi i futjes së sendeve të ndaluara në burgje u vlerësua në nivele të papranueshme, për rrjedhojë sikurse dihet në fund të vitit 2015 me ndryshimet ligjore, futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në burg u shtua si vepër penale e veçantë në Kodin penal, në kapitullin "Vepra Penale Kundër Drejtësisë", konkretisht neni 324/a.

¹² E cila është edhe dokument i klasifikuar "sekret" dhe pak persona të pajisur me certifikatë sigurie janë në dijeni të saj.

¹³ Madje nga ambientet e burgjeve janë urdhëruar apo porositur vrasje personash apo dhe vazhduar trafikë të mundshme të lëndëve narkotike edhe me element transnacional.

¹⁴ **Neni 24 Detyrimet të paraburgosurve dhe të dënuarve**

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit kanë për detyrë: c) të mos mbajnë dhe qarkullojnë sende të ndaluara, të cilat rrezikojnë rendin, jetën dhe shëndetin e të paraburgosurve e të dënuarve dhe personelit, objekte që përbëjnë vepër penale, mjete që ndikojnë negativisht në hetim, si dhe vlera monetare të çdo lloji; f) të informojnë menjëherë drejtorin e IEVP-së për rrethanat që mund të rrezikojnë sigurinë, jetën e të paraburgosurve dhe të dënuarve ose shkeljen e rregullave të brendshme në IEVP.

- Asnjë prej të burgosurve nuk bashkëpunoi për të treguar pronësinë e celularit dhe qëllimin e përdorimit të tij. Siç dihet aparati celular është një mjet efikas komunikimi, ndërveprimi e koordinimi – veprimtari për të cilat me qëllim parandalimin e tyre sipas ligjit 108/2018 për kategori të caktuar të burgosurish sikurse janë këta të paraburgosur¹⁵ është parashikuar edhe vendosja e tyre në rregjim të posaçëm nëpërmjet marrjes së masave të brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë¹⁶
2. Gjatë gjithë kohës së kontrollit secili prej këtyre të burgosurve me veprime aktive jo vetëm nuk janë bindur por kanë kundërshtuar, kërcënuar e kanosur punonjësit e policisë të përfshirë në aksion
- a. Siç shpjegohet hollësisht në aktet e mbajtura (raport shërbimi dhe deklaratatë të secilit punonjës) secili prej të burgosurve është përfshirë në veprat penale të kundërshtimit, kanosjes, fyerjes duke iu drejtuar punonjësve të veçantë dhe të gjithëve në tërësi me tone të larta hakërryese dhe qartësisht kërcënuese në adresë edhe të familjarëve të tyre...”
- *A e dini se kush jemi ne....*
 - *a e dini se kush jam unë o spiuna....*
 - *ska bir kurve që të prangosë mua...*
 - *do keni probleme me mua dhe e keni personale tani e tutje...*
 - *ka për T'ju qi robt dhe do tju zhduk e degjeneru o legena...*
 - *du tju vrasim e presim ju që po na ngacmoni...nuk kontrolloni dot Avdylajt ju.*
 - *A më njëf mua?? E di kush jam??!*
 - *Do keni probleme!! Ne ju njohim!!*
 - *Jua dimë shtëpitë ku banoni!!*
 - *Ty të njoh se më ke shoqëruar për vizitë në spital, madje më ke bërë edhe foto*
 - *Të njohim shumë mirë ty o Shpëtim!! Ç'të duhet ty me na kontrollu? Kush e paska dhënë këtë urdhër?!*
 - *Ta tregojmë ne qefin ty, ke për ta shiku këtë punë se çfarë kemi për të bërë?*
- b. Kërcënimet dhe kanosjet të shoqëruara me kundërshtim fizik ndaj punonjësve të policisë vijuan gjatë gjithë kohës – edhe kur në mbështetje të këtyre forcave kanë shkuar forca të tjera sigurie, konkretisht me tone të larta hakërryese dhe qartësisht kërcënuese vijonin
- **Të njohim!!Do të vrasim!!**

¹⁵ të përcaktuar në neni 13/1/1 të ligjit 9238 datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", konkretisht të burgosurit që hetohen apo gjykohen për këto vepra penale, të parashikuara në nenet 79, shkronja "ç", 79/a, 79/b, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 283, paragrafi 3, 283/a, paragrafi 3, 284, paragrafi 3, 284/a, 284/c, paragrafi 3, 284/ç, paragrafi 3, 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste.

¹⁶ siç dihet në funksion të ruajtjes e rendit dhe të sigurisë dhe/ose parandalimin e komunikimit me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizatata të tjera Sipas ligjit 108/2018 për kategori të caktuar të burgosurish është parashikuar edhe vendosja e tyre në rregjim të posaçëm nëpërmjet marrjes së masave të brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë, që lidhen, me nevojën për të parandaluar kontaktet me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizatata të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë: ndërveprimin me të burgosurit apo të paraburgosurit e tjerë, të cilët i përkasin së njëjtës organizatë ose të organizatave të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë; komunikimin apo shkëmbimin e sendeve ndërmjet të dënuarve apo të paraburgosurve që i përkasin grupimeve të ndryshme

- Do të qërojmë!! Do të heqim qafe!!
 - Për 10 ditë unë jam jashtë! Mbaje mënd fytyrën time!! Do takohemi!!
- c. Kundërshtimi me forcë ndaj punonjësve të policisë, siç arsyetohet në aktet e mbajtura konsiston:
- gjatë momentit kur punonjësit e policisë kanë bllokuar derën e bankës brenda dhomë që të mos hidheshin sendet e ndaluara dy të burgosur janë afruar me rrëmbim e insistim për tu futur në tualet duke u konfrontuar me të shtyra me trup me bërryla – madje kanë përplasur policin me shpinë pas derës së tualetit
 - pasi janë nxjerrë nga dhoma kanë vijuar duke shtyrë me trup për tu futur sërish në dhomë
3. Siç u evidentua gjatë gjithë kohës së kontrollit dhe gjatë qëndrimit në korridor të sektorit të burgut këta të burgosur kundërshtimet, kërcënimet dhe kanosjet i shoqëronin me zë të lartë e tone të forta, nga të cilat spikaste e shumë përsëritur thirrja se:

- A e dini se kush jemi ne....
- *nuk kontrolloni dot Avdylajt ju ...*

si dhe deklarimi i një prej të burgosurve (Saimir Gjepali) që sendi i ndaluar (celulari) është i një të burgosuri i një dhomë tjetër, si dhe përpjekja e tij për të shkuar tek dhoma e atij të burgosuri (pastruesit)

Ishin të dukshme që këto veprime kishin qartazi qëllim për të destabilizuar burgun, për të nxitur edhe të burgosurit e tjerë për rrebelim si dhe për të përfituar nga nënshtrimi i tyre, por edhe për të dhënë alarmin për të burgosurit e tjerë për kontrollin me qëllim që të kenë kohë për të eliminuar sendet e ndaluara që mund të kenë ata.

Në fakt kështu ndodhi:

- të burgosurit e dhomave fqinjë (3,5,6 dhe 8) u solidarizuan me ta dhe vijuan duke ju rënë dyerve me forcë dhe duke bërtitur me zë të lartë që 'ju nuk kontrolloni dot Avdylajt
- të burgosurit e dhomës 5, siç u konstatua dhe dokumentua me raport shërbimi, nga dritarja e dhomës hodhën një send të ndaluar – nga verifikimi i të cilit u konstatua se ishte aparat celular i dëmtuar në të djathtë foto e aparatit celular që u hoq nga dritarja e dhomës fqinjë me ta; Ky aparat u bllokua nga OPGJ të SHKBB të cilët vijuan me veprime të mëtejshme





bashkëlidhur gjeni edhe CD me pamje të regjistruara nga kamerat e sigurisë në korridor të sektorit – nga vërtetimi i të cilave dalin qartë kundërshtimet e të burgosurve ndaj policisë (shtyrjet etj.) si dhe krijohet bindja për brutalitetin e komunikimit të tyre – siç ilustrohet edhe në këto foto

III. Sikurse shihet, këta të paraburgosur kanë konsumuar (*poseduar send të ndaluar por edhe kërcënuar punonjësit e policisë gjatë kryerjes së detyrës*) shkeljen më të rëndë të mundshme në burgje – rebelim¹⁷ të shoqëruar me akte dhune dhe kërcënime (!) për rrjedhojë në referencë të neni 55 pika a, dhe 56 të Ligjit Nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” të ndryshuar, për vendosjen e tyre në regjim të mbikëqyrjes të veçantë(!) ndaj secilit prej tyre është nxjerrë urdhër për kalim në rrëgjim mbikëqyrje të posaçme respektivisht si vijon:

1. Urdhër nr.4950/1prot. datë 23.5.2020 për kalim në rrëgjim të mbikëqyrjes së veçantë të të burgosurit Hajri Myrteza Seferi me afat 3 mujor
2. Urdhër nr.4950/2prot. datë 23.5.2020 për kalim në rrëgjim të mbikëqyrjes së veçantë të të burgosurit **Astrit Zeqo Avdyli alias Avdyli Sulejmani** me afat 3 mujor
3. Urdhër nr.4950/3prot. datë 23.5.2020 për kalim në rrëgjim të mbikëqyrjes së veçantë të të burgosurit **Altin Zeqo Avdyli** me afat 3 mujor
4. Urdhër nr.4950/4prot. datë 23.5.2020 për kalim në rrëgjim të mbikëqyrjes së veçantë të të burgosurit **Saimir Abdyl Gjepalime** afat 3 mujor
5. Urdhër nr.4950/5prot. datë 23.5.2020 për kalim në rrëgjim të mbikëqyrjes së veçantë të të burgosurit **Giovani Giuseppe Di Cosimo alias Giovani Petrone** me afat 1 mujor

IV. Lidhur me kërcënimet apo goditjet, ndaj punonjësve të policisë që lidhen për shkak të detyrës, vlerësojmë se veprime të tilla kanë edhe elementet e veprave penale, konkretisht “Kanosja për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal¹⁸.

- a. Me ndryshimet e fundit në Kodin Penal, siç dihet ndër të tjera është sanksionuar edhe se: edhe vepra të tjera dhune (përveç goditjes) ndaj punonjësit që kryen detyrë shtetërore dënohen ... - masë dënimi e cila përshkallëzohet kur kjo veprë kryhet ndaj punonjësit të policisë apo më shumë akoma kur kryhet në mjediset e institucionit ku personi ushtron detyrën.
- b. Është e vërtetë që personat që kanë kryer kanosjen ndaj punonjësve të policisë në IEVP Jordan Misja janë të burgosur çka dmth se apriori mendohet se kanë se si të realizojnë veprimin hakmarrës. Mirëpo për shkak të kapacitetit të fortë kriminal, siç shprehen dhe paralajmërojnë bindshëm ata, kjo mundësi ekziston. Ka patur raste sipas të cilave të burgosur të caktuar kanë porositur e kryer veprime të dhunshme kundër punonjësve të IEVP-ve – pikërisht për shkaqe analoge kur punonjësit e institucionit kanë marrë kërcënime nga të burgosurit për shkak të detyrës që kanë kryer në burg.

V. Sa lidhet me gjetjen e sendit të ndaluar në burg (aparatis celular) parashtrijmë vlerësimin se është e domosdoshme që hetimet të mos kufizohen vetëm në faktin e posedimit të sendit të

¹⁷ Neni 270 **Rebelimi i të burgosurve** Përdorimi i dhunës, nga ana e të burgosurve ndaj punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo në shërbim publik, që bëhet për ta penguar në ushtrimin e detyrës apo të shërbimit ose për shkak të veprimtarisë, dënohet me gjobë ose me burgim gjër në pesë vjet.

¹⁸ “Kanosja për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal. Kanosja serioze për vrasje apo për plagosje të rëndë, që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjër në dy vjet.

ndaluar për efekt të klasifikimit të paragrafit të parë të veprës penale të parashikuar nga neni 324/a të K. Penal, si dhe mos kallëzim krimi të parashikuar nga neni 300 i K. Penal, por sygjerohet që është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera si psh ekzaminim i hollësishëm i të dy aparateve¹⁹ e kartave sim etj. – përmes të cilave të tentohet të arrihet ndër të tjera edhe verifikimi i bashkëpunëtorëve në futjen e aparatit celular në burg – pra vërtetimi edhe i veprës penale të parashikuar nga paragrafi 2 i nenit 324/a të K. Penal.

Dihet që hetimi i këtyre rasteve impakton drejtpërdrejtë në

- Kritjen e sigurisë në burgje,
- Ndërprerjen e lidhjeve kriminale të të burgosurve, por dhe në
- identifikimin e procedimin e pjesëtarëve të stafeve tona të cilët bashkëpunojnë e madje mundësojnë e futin e sende të ndaluara në burgje.

Bashkëlidhur përveç urdhrave të vendosje në rregjim të mbikëqyrjes së posaçme ndaj secilit prej të burgosurve të më sipërme po dërgojmë materiale të tjera:

1. Shkresa nr 2604 prot, datë 22.05.2020 të IEVP Jordan Misja Tiranë “Dërgim informacioni për të paraburgosurit Hajri Seferi, Altin Avdyli, Saimir Gjepali dhe Giovanni Di Cosimo”.
2. Urdhrin nr. 1094/1 datë 22.05.2020 për fillimin e procedurave disiplinore për të paraburgosurin **Hajri Seferi**.
3. Vendimin nr. 1094/2 datë 22.5.2020 për masë disiplinore për të burgosurin Hajri Seferi.
4. Raport –Shërbimi nr.1094 datë. 22.05.2020.
5. Raport –Shërbimi nr.1088 datë. 22.05.2020.
6. Informacion mbi gjendjen shëndetësore për të paraburgosurin Hajri Seferi.
7. Shkurtim nr. 157 datë. 21.10.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë
8. Shkurtim nr. 65 datë. 08.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës
9. Urdhër ekzekutimi i datës.08.03.2019 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
10. Urdhrin nr. 1093/1 datë 22.05.2020 për fillimin e procedurave disiplinore për të paraburgosurin **Saimir Gjepali**.
11. Vendimin nr. 1093/2 datë 22.05.2020 për dhënje masë disiplinore për të paraburgosurin Saimir Gjepali.
12. Raport –Shërbimi nr.1093 datë. 22.05.2020.
13. Raport –Shërbimi nr.1088 datë. 22.05.2020.
14. Informacion mbi gjendjen shëndetësore për të paraburgosurin Saimir Gjepali.
15. Shkurtim nr. 157 datë. 21.10.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda
16. Urdhrin nr. 1096/1 datë 22.05.2020 për fillimin e procedurave disiplinore për të paraburgosurin **Altin Avdyli**.
17. Vendimin nr. 1096/2 datë 22.05.2020 për dhënje masë disiplinore për të paraburgosurin **Altin Avdyli**.

¹⁹ Celularit që u gjet në dhomën e tyre dhe të celularit të dëmtuar që u hodh nga dritarja e dhomës fqinjë



[shqiptaria.com]